FM	Departamenti KMDP		Audiovizuale	Saturation	cope	1	233,700	233,700	-	-	-
FM	Departamenti KMDP		Audiovizuale	Cubase 10 Pro (Software)	cope	5	70,000	350,000	-	-	-
FM	Departamenti KMDP		Audiovizuale	Kufje	cope	10	11,000	110,000	-	-	-
FM	Departamenti KMDP		Audiovizuale	Karta zëri	cope	10	15,000	150,000	-	-	-
								-	-	-	-
FM	Departamenti Kanto		kompjuter	Laptop	cope	1	132,800	132,800	-	-	-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
SENATI AKADEMIK
KRYETARI

Nr. 19 prot.

Tiranë, më 20/07/2023

Lënda: Mbi Miratimin e Propozimit të Senatit Akademik.

BORDIT TË ADMINISTRIMIT UART
KRYETARI
Z. Lavdrim SAHITAJ

I nderuar,

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, (Funksionet e Senatit Akademik); po Ju dërgojmë për MIRATIM Vendimin nr. 33, datë 20/07/2023 “Mbi propozimin e PBA 2024-2026 dhe Deklaratën e Misionit të Uart”.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin,

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Kastriot ÇAUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK**

VENDIM

Nr. 33, datë 20/07/2023

MBI

**“PROPOZIMIN PËR MIRATIMIN E PROJEKT-BUXHETIT AFATMESËM
2024-2026 DHE DEKLARATËS SË MISIONIT TË UNIVERSITETIT TË
ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Arsimit nr. 27, datë 29.12.2017 për “Strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe pasi shqyrtoi Relacionin e Rektoratit, relatuar nga Administratorja e Universitetit të Arteve Znj. Alma Sinanaj dhe pasi e diskutoi,

V E N D O S I:

1. Propozimin për miratimin e “Projekt-Buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe Deklaratës së Misionit ” në Universitetin e Arteve, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim ti dërgohet Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve për miratim.
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe te transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Genc FUGA

Erlind FUSHA (Student FAB)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
ADMINISTRATOR

Nr. 689/19 prot.

Tiranë, më 14/07/2023

Lënda: Propozim për Projekt-Buxhetin Afatmesëm (PBA) 2024-2026 të Universitetit të Arteve.

Senatit Akademik të Universitetit të Arteve

Projekt-buxheti 2024-2026 i Universitetit të Arteve, i cili është hartuar bazuar në Ligjin Nr.80/2015, datë 22.5.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimit Nr. 5, Datë 28.02.2023 "Për procedurat standarte të përgatitjes së PBA", Ligj Nr.7703 ndryshuar, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", shkresa e MASR "Për miratimin e numrit të punonjësve" Nr.7643 date 16.10.2014, VBA Nr.17 date 05.07.2023 "Miratimi i strukturës dhe nivelit të pagave", është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Nr. Llog	Emërtimi	Viti 2024 (lek)	Viti 2025 (lek)	Viti 2026 (lek)
600	Paga	444,367,103	444,367,103	444,367,103
601	Sigurime	66,609,398	66,609,398	66,609,398
602	Mallra dhe shërbime	70,727,761	71,621,881	71,621,881
605	Transferta korrente të huaja	312,000	312,000	312,000
606	Transferta për individët	12,240,000	12,240,000	12,240,000
231	Investime	96,074,011	5,427,134	4,696,612
	TOTALI	690,330,273	600,577,516	599,846,994

Në zërin "Paga", për PBA 2024-2026, janë përfshirë elementet e paraqitur në tabelën e mëposhtme.


Nr. Llog	Emertimi	Vlera (lek)
600	Paga - Përsoneel i brendshëm	382,239,786
600	Paga - Përsoneel i jashtëm	11,184,000
600	Orë mbi normë - Përsoneel akademik	30,315,550
600	Fondi i vecantë	20,627,767
	TOTALI	444,367,103



A. Keaj
1



Pesha specifike e cdo zëri, në krahasim me vlerën totale të shpenzimeve për paga, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm



Për cdo element të tabelës së mësipërme, në vijim, janë paraqitur sqarimet përkatëse.

“Paga - Përsonel i brendshëm” – në këtë zë është përfshirë vlera e shpenzimeve për paga për 267 (dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) punonjës të brendshëm. Punonjësit e brendshëm, bazuar në funksionin e tyre në UART, ndahen në dy kategori:

1. Personel Akademik (punonjës mësimore)
2. Personel Administrativ

Për **Përsonelin Akademik**, i cili ka në përbërjen e tij **187 punonjës**, shpenzimet për paga, janë parashikuar të jenë **299.875.986 lek** ose rreth 78% e fondit të “Paga - Përsonel i brendshëm”. Burimet e financimit të shpenzimeve për paga për përsonelin akademik janë buxheti i shtetit dhe të ardhurat e UART.

Buxheti për zërin **“Paga - Përsonel akademik”**, i ndarë sipas fakulteteve, është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Fakulteti	Buxheti Paga	Pesha specifike
Fakulteti i Arteve te Bukura	69,392,694	23%
Fakulteti i Artit Skenik	88,605,677	30%
Fakulteti i Muzikes	141,877,615	47%
TOTALI	299,875,986	

Për **Përsonelin Administrativ**, i cili ka në përbërjen e tij **80 punonjës**, shpenzimet për paga, janë parashikuar të jenë 82.363.800 lek ose rreth 22% e fondit të “Paga - Përsonel i brendshëm”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

“Paga - Përsonei i jashtëm” - në këtë zë është përfshirë vlera e shpenzimeve për paga për personelin e jashtëm.

Për personelin akademik, orët mësimore për ciklin e parë të studimeve “Bachelor” dhe “Master” janë parashikuar të jenë 13.320 orë. Burimi i financimit është parashikuar të jenë të ardhurat e UART Sjellim në vëmendje që orët mësimore janë në përpjestim të drejtë me numrin e studentëve që parashikohen të jenë për vitin akademik 2023 -2024.

“Orë mbi normë - Përsonei akademik” - në këtë zë, me vlerë 30.315.550 lek, është përfshirë vlera e shpenzimeve për pagesën e orëve mbinorme të personelit akademik të brendshëm. Burimi i financimit është parashikuar të jetë buxheti i shtetit. Orët mbinormë, për ciklin e parë të studimeve “Bachelor” dhe “Master”, janë parashikuar të jenë 28.710 orë.



“Fondi i vecante (5%)” - në këtë zë është përfshirë vlera e fondit të vecantë, i cili bazuar në VKM, është 5% e fondit të pagave (përsonei i brendshëm).

Në zërin **“Sigurime shoqërore dhe shëndetësore”**, për vitet 2024 - 2026 janë përshfshirë elementët e paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Nr. Llog.	Emertimi	Vlera (lek)	Pesha specifike
601	Sigurime - Personel I brendshem	63,304,180	95%
601	Sigurime - Personel I brendshem mbinorme	1,515,778	2%
601	Sigurime - Personel i jashtem	1,789,440	3%
TOTALI		66,609,398	

Në zërin **“Mallra dhe shërbime”** – në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për mallra dhe shërbime të cilat janë parashikuar të realizohen gjatë vitit 2024. Parashikimi i shpenzimeve për këtë zë është bazuar në kërkesat e paraqitura dhe të argumentuara nga Fakultetet dhe njësitë e tjera të Universitetit të Arteve, diskutuar dhe miratuar në GMS, si dhe shpenzimeve të realizuara gjatë viteve parardhëse.

Nr.	Emertimi	Shpenzime Viti 2024 (lek)	Pesha specifike
1	Kancelari	470,000	0.66%
2	Materiale per pastrim	330,000	0.47%
3	Materiale elektrike	320,000	0.45%
4	Materiale hidraulike	290,000	0.41%
5	Matariale per funksionimin e pajisjeve te zyres	380,000	0.54%
6	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale	495,060	0.70%
7	Furnizime dhe materiale te tjera zyre e te pergjithshme	480,000	0.68%
8	Libra dhe publikime profesionale	1,210,800	1.71%
9	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	360,000	0.51%
10	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	120,000	0.17%
11	Energji elektrike	5,000,000	7.07%



3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

12	Uje	1,200,000	1.70%
13	Sherbime telefonike	450,000	0.64%
14	Sherbime postare	10,000	0.01%
15	Sherbim ngrohje	1,200,000	1.70%
16	Sherbime bankare	10,000	0.01%
17	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes	7,868,460	11.12%
18	Sherbime te printimit dhe publikimit	723,000	1.02%
19	Kosto te trajnimit dhe seminare	100,000	0.14%
20	Sherbime te tjera	16,200,685	22.91%
21	Karburant	120,000	0.17%
22	Pjese kembimi	60,000	0.08%
23	Shpenzime per Siguracion per makina	80,000	0.11%
24	Udhetim brenda vendit	3,795,700	5.37%
25	Udhetim jashte vendit	1,801,700	2.55%
26	Shpenzime per mirembajtje objekteve ndertimore	480,000	0.68%
27	Shpenzime mirembajte rrjeteve hidraulike elektrike	480,000	0.68%
28	Shpenzime mirembajte Pajisjeve, veglave te punes	460,000	0.65%
29	Shpenzime per mirembajte mjeteve te transportit	60,000	0.08%
30	Shpenzime per mirembajte Pajisje zyre	480,000	0.68%
31	Shpenzime per pritje percjellje	920,000	1.30%
32	Shpenzim sigurim ndertese	480,000	0.68%
33	Shpenzime per honorare	10,959,600	15.50%
34	Shpenzime tatim dhe taksa	850,000	1.20%
35	Shpenz. te tjera materiale dhe sherbime operative	12,482,756	17.65%
TOTALI		70,727,761	

Në vijim po japim një shpjegim për zërat e paraqitur në tabelën e mësipërme, të cilat nuk shprehin specifikisht llojin e shpenzimit:

- Zëri “Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës” – në këtë zë janë përfshirë blerje për bojë printeri dhe fotokopje.
- Zëri “Materiale për funksionimin e pajisjeve speciale” – në këtë zë është përfshirë blerja e materialeve për mirembajtjen e veglave muzikore.
- Zëri “Furnizime dhe materiale të tjera zyre e të përgjithshme” – në këtë zë janë përfshirë blerja e pjesëve të këmbimit për kompjuter dhe sistemin e internetit.
- Zëri “Materiale për funksionimin e pajisjeve speciale” – në këtë zë është parashikuar blerja e pjesëve të këmbimit për veglat muzikore të Fakultetit të Muzikës.
- Zëri “Të tjera materiale dhe shërbime speciale” – në këtë zë është parashikuar hostimi i faqes zyrtare të UART.
- Zëri “Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik” – në këtë zë është përfshirë printimi i diplomave, rregjistrave, librezave të studentëve, kartelave e të ngjashme.
- Zëri “Libra dhe publikime profesionale” – në këtë zë janë botimet e fakulteteve.
- Zëri “Shërbime telefonike” – në këtë zë janë përfshirë shpenzimet telefonike.
- Zëri “Shërbime të printimit dhe publikimit” – në këtë zë është përfshirë printimi i posterave dhe të ngjashme që do të promovojnë aktivitetet e UART.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Zëri “Shërbime të tjera” – në këtë zë është përfshirë tarifa e akreditimit të programeve te ciklit te parë (Bachelor), te cilat jane 34 programe, per të tre fakultet e UART.
- Zëri “Udhetim brenda vendit” – në këtë zë është përfshirë shpenzimet per realizimin e praktikave mësimore, bazuar ne VKM 997 date 10.12.2010.
- Zëri “Shpenzime mirëmbajtje pajisje, veglave të punës” – në këtë zë është përfshirë mirëmbajtja e pajisjeve teknike te njërive te UART.
- Zëri “Shpenzime për mirëmbajtje pajisje zyre” – në këtë zë është përfshirë mirëmbajtja e printerave dhe fotokopjeve.
- Zëri “Shpenzime per pritje percjellje” – në këtë zë është akomodimi i stafit akademik te ftuar nga jashte dhe brenda vendit, ne kuader te organizimit te konferencave te ndryshme shkencore si dhe aktiviteve artistike te Universitetit.
- Zëri “Shpenzime për mirëmbajtje të objekteve ndërtimore” – në këtë zë është përfshirë riparimi(mirëmbajtja) i domosdoshëm i disa ambjenteve të UART.
- Zëri “Shpenzime per honorare” – në këtë zë jane përfshirë vlera e shpenzimeve për pagesat që realizohen ndaj antarëve të Senatit (9 muaj/vit) , Bordi i Administrimit (12 muaj) dhe pagesat ndaj modeleve etj.
- Zëri “Shpenz. të tjera materiale dhe shërbime operative” – në këtë zë është përfshirë blerja e materialeve që shërbejnë për procesin mësimor si : materiale për serigrafi, materiale rrobaqepsie, materiale grafike, materiale për fotografi, materiale për skulpturë, materiale për qeramikë, materiale për pikturë monumentale etj. Gjithashtu janë përfshirë dhe materiale për mirëmbajtjen e institucionit.

Ne tabelën e mëposhtme është paraqitur shpërndarja e zërit “**Mallra dhe shërbime**” , bazuar në destinacionin ku do të realizohet shpenzimi.

Nr.	Njesia	Shpenzime Viti 2024 (lek)	Pesha specifike
1	Fakulteti i Arteve te Bukura	22,272,631	31%
2	Fakulteti i Artit Skenik	7,586,240	11%
3	Fakulteti i Muzikes	11,339,930	16%
4	Shpenz. te perbashketa	29,528,960	42%
TOTALI		70,727,761	

Ne tabelen e meposhtme janë përfshirë shpenzimet për mallra dhe shërbime të cilat janë parashikuar të realizohen gjatë vitit 2025-2026.

Nr.	Emertimi	Shpenzime Viti 2025 (lek)	Shpenzime Viti 2026 (lek)
1	Kancelari	470,000	470,000
2	Materiale per pastrim	330,000	330,000
3	Materiale elektrike	320,000	320,000
4	Materiale hidraulike	290,000	290,000
5	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres	380,000	380,000
6	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale	1,389,180	1,389,180
7	Furnizime dhe materiale te tjera zyre e te pergjithshme	480,000	480,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

8	Libra dhe publikime profesionale	1,210,800	1,210,800
9	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	360,000	360,000
10	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	120,000	120,000
11	Energji elektrike	5,000,000	5,000,000
12	Uje	1,200,000	1,200,000
13	Sherbime telefonike	450,000	450,000
14	Sherbime postare	10,000	10,000
15	Sherbim ngrohje	1,200,000	1,200,000
16	Sherbime bankare	10,000	10,000
17	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes	7,868,460	7,868,460
18	Sherbime te printimit dhe publikimit	723,000	723,000
19	Kosto te trajnimit dhe seminare	100,000	100,000
20	Sherbime te tjera	16,200,685	16,200,685
21	Karburant	120,000	120,000
22	Pjese kembimi	60,000	60,000
23	Shpenzime per Siguracion per makina	80,000	80,000
24	Udhetim brenda vendit	3,795,700	3,795,700
25	Udhetim jashte vendit	1,801,700	1,801,700
26	Shpenzime per mirembajtje objekteve ndertimore	480,000	480,000
27	Shpenzime mirembajte rrjeteve hidraulike elektrike	480,000	480,000
28	Shpenzime mirembajte Pajisjeve, veglave te punes	460,000	460,000
29	Shpenzime per mirembajte mjeteve te transportit	60,000	60,000
30	Shpenzime per mirembajte Pajisje zyre	480,000	480,000
31	Shpenzime per pritje percjellje	920,000	920,000
32	Shpenzim sigurim ndertese	480,000	480,000
33	Shpenzime per honorare	10,959,600	10,959,600
34	Shpenzime tatim dhe taksa	850,000	850,000
35	Shpenz. te tjera materiale dhe sherbime operative	12,482,756	12,482,756
TOTALI		71,621,881	71,621,881

Në zërin **“Transferta korrente të huaja”** – në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për pagesën e kuotës vjetore të “AEC” me vlerë 1300 Euro dhe ELIA me vlerë 1300 Euro.

Në zërin **“Transferta për individët”** – në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për pagesat e bursave të studenteve për 144 studentë.






TE ARDHURAT 2024-2026

Të ardhurat e parashikuara të realizohen, nga Universiteti i Arteve dhe burimet e krijimit të tyre, për periudhën 2024-2026, janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Nr.	Burimi I krijimit te te ardhurave	Viti 2024 (lek)	Viti 2025 (lek)	Viti 2026 (lek)
1	Tarifë shkollimi	37,342,885	37,342,885	37,342,885
2	Tarifë konkur. & regjistr.	2,480,800	2,480,800	2,480,800
3	Shërbim salle	3,000,000	3,000,000	3,000,000
4	Qira ambjente	2,364,804	2,364,804	2,364,804
5	Diploma, vërtetime etj.	300,000	300,000	300,000
	TOTALI	45,488,489	45,488,489	45,488,489

Pesha specifike e cdo zëri të të ardhurave, në krahasim me vlerën totale, për vitin 2024, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



- ❖ Të ardhurat nga tarifat e shkollimit, konkurrimit dhe rregjistrimit janë bazuar në numrin aktual të studentëve (viti akademik 2021 – 2022), si dhe ecurinë e viteve paraardhës. Tarifat e shkollimit, konkurrimit dhe rregjistrimit janë llogaritur bazuar në vendimet e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të UA.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i studentëve që është parashikuar të frekuentojnë Universitetin e Arteve si dhe të ardhurat që parashikohen të arkëtohen nga pagesa e tarifës së shkollimit.


7



Fakulteti	Viti 2024		Viti 2025		Viti 2026	
	Nr. Stud.	Te ardhura	Nr. Stud.	Te ardhura	Nr. Stud.	Te ardhura
Fakulteti i Muzikes	406	19,350,010	406	19,350,010	406	19,350,010
Fakulteti i Artit Skenik	238	9,265,375	238	9,265,375	238	9,265,375
Fakulteti i Arteve te Bukura	311	8,727,500	311	8,727,500	311	8,727,500
TOTALI	955	37,342,885	955	37,342,885	955	37,342,885

- ❖ “Shërbim salle” – në këtë zë përfshihen të ardhurat që parashikohen të realizohen nga dhënia me qera e Sallës së Koncerteve, Black Box, Amfiteatrit, Galerisë së FAB.
- ❖ “Qera ambjenti” – në këtë zë përfshihen të ardhurat që parashikohen të realizohen nga dhënia me qera për afat jo më të vogël se 1-vjecar të ambjenteve të UA.
- ❖ “Diploma, vërtetime etj.” – në këtë zë përfshihen të ardhurat që parashikohen të realizohen nga dhënia e diplomave studentëve të cilët frekuentojnë dhe përfundojnë studimet pranë UART, nga lëshimi i vërtetimeve të ndryshme që ofron UART si vërtetime për pagë, për listë notash, për programe studimi etj.

Për përgatitjen e kërkesave për investime kemi patur në konsideratë:

1. Të zhvillojmë investime kapitale në ato objekte dhe zëra që nuk preken nga një zhvillim fizik i mundshëm i UA në të ardhmen.
2. Të plotësojmë nevojat e domosdoshme që ka UART për një zhvillim normal të mësimin dhe për rritjen e performancës së tij.

Në **Tabelën Nr.1 dhe Nr.2**, bashkëngjitur këtij materiali, janë paraqitur në mënyrë të detajuar kërkesat për investime për periudhën 2024–2026.

Blerje Pajisje audiovizuale, fotokopje, kompjuter, kondicioner, libra, mobilim, mirëmbajtje ndertesa, pajisje teknike, printer, skaner, programe kompjuterike, projektor - janë të bazuara në nevojat e domosdoshme që kanë laboratorët e fakultetet. Kjo referuar kërkesave të tyre për të siguruar zhvillimin normal të procesit mësimor.

Në **Tabelën Nr.3** (bashkëngjitur materialit) janë paraqitur burimet e financimit të PBA 2024-2026 të Universitetit të Arteve.



Tabela Nr.1 _____ Investime PBA 2024 - 2026

Nr	Emertimi I investimit	Viti 2024 (lek)	Viti 2025 (lek)	Viti 2026 (lek)	Shenime
1	Pajisje audiovizuale	13,052,577	3,866,934	3,622,412	Analitike ne Tab.2
2	Fotokopje	313,860	-	-	Analitike ne Tab.2
3	Kompjuter etj	11,993,549	25,200	25,200	Analitike ne Tab.2
4	Sisteme kondicionimi	795,000	-	-	Analitike ne Tab.2
5	Libra	600,000	200,000	200,000	Analitike ne Tab.2
6	Mobilim	1,879,320	-	-	Analitike ne Tab.2
7	Ndertesa (mirembajtje)	4,131,622	-	-	Analitike ne Tab.2
8	Pajisje teknike etj	26,347,250	154,000	154,000	Analitike ne Tab.2
9	Printer,skaner	1,224,633	-	-	Analitike ne Tab.2
10	Programe kompjuterike	18,000,000	-	-	Analitike ne Tab.2
11	Projektor	1,168,400	1,181,000	695,000	Analitike ne Tab.2
12	Te tjera paisje zyre	1,807,800	-	-	Analitike ne Tab.2
13	Vegla muzikore	14,760,000	-	-	Analitike ne Tab.2
TOTALI		96,074,011	5,427,134	4,696,612	



Tabela Nr.2 Investime VITI 2024

Nr.	Emertimi	Pesha Specifike						
		Fakulteti! Arteve te Bukura	Fakulteti! Artit Skenik	Fakulteti! Muzikes	Black Box	Biblioteka	UART Rektorati Administrata	TOTALI (lek)
		36%	34%	18%	3%	4%	6%	
1	Pajisje audiovizuale	7,894,032	4,014,045	1,043,700	100,800	-	-	13,052,577
2	Fotokopje	-	-	313,860	-	-	-	313,860
3	Komputer etj	1,943,354	3,457,609	1,279,790	-	2,156,264	3,156,532	11,993,549
4	Sisteme kondicionimi	-	665,000	-	-	130,000	-	795,000
5	Libra	-	-	-	-	600,000	-	600,000
6	Mobilim	296,000	300,000	-	1,283,320	-	-	1,879,320
7	Ndertesa (mirembajtje)	-	3,474,122	-	657,500	-	-	4,131,622
8	Pajisje teknike etj	23,134,060	521,990	-	665,000	-	2,026,200	26,347,250
9	Printer, skaner	449,880	152,725	63,582	-	558,446	-	1,224,633
10	Programme kompjuterike	-	18,000,000	-	-	-	-	18,000,000
11	Projektor	584,200	-	292,100	-	146,050	146,050	1,168,400
12	Te tjera paisje zyre	-	1,807,800	-	-	-	-	1,807,800
13	Vegla muzikore	-	-	14,760,000	-	-	-	14,760,000
	TOTALI	34,301,526	32,393,291	17,753,032	2,706,620	3,590,760	5,328,782	96,074,011



Handwritten signatures in blue ink, including a large stylized signature and a smaller one below it.

Tabela Nr.3

VITI 2024

Burimi I financimit	Paga (Llog.600)	Sigurime (Llog.601)	Mallra & Sherbime (Llog.602)	Transfe. jashte (Llog.605)	Bursa (Llog.606)	Investime (Llog.231)	TOTALI (lek)
Buxheti i shtetit	415,559,393	62,268,566	70,727,761	312,000	12,240,000	83,734,064	644,841,784
Te ardhurat	28,807,710	4,340,832	-	-	-	12,339,947	45,488,489
TOTALI	444,367,103	66,609,398	70,727,761	312,000	12,240,000	96,074,011	690,330,273

VITI 2024

Burimi I financimit	Paga (Llog.600)	Sigurime (Llog.601)	Mallra & Sherbime (Llog.602)	Transfe. jashte (Llog.605)	Bursa (Llog.606)	Investime (Llog.231)	TOTALI (lek)
Buxheti i shtetit	415,559,393	62,268,566	64,709,068	312,000	12,240,000		555,089,027
Te ardhurat	28,807,710	4,340,832	6,912,813			5,427,134	45,488,489
TOTALI	444,367,103	66,609,398	71,621,881	312,000	12,240,000	5,427,134	600,577,516

VITI 2025

Burimi I financimit	Paga (Llog.600)	Sigurime (Llog.601)	Mallra & Sherbime (Llog.602)	Transfe. jashte (Llog.605)	Bursa (Llog.606)	Investime (Llog.231)	TOTALI (lek)
Buxheti i shtetit	415,559,393	62,268,566	63,978,546	312,000	12,240,000		554,358,505
Te ardhurat	28,807,710	4,340,832	7,643,335			4,696,612	45,488,489
TOTALI	444,367,103	66,609,398	71,621,881	312,000	12,240,000	4,696,612	599,846,994





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI

Nr. 689 prot

Tiranë, më 14/07 2023

RELACION

Mbi hartimin e deklaratës së misionit të Universitetit të Arteve për vitet akademike
2024-2026

Grupi i punës për menaxhimin Strategjik në Universitetin e Arteve, sot në datën 19.07.2023, pasi u njoh me dokumentat e ardhura nga fakultetet në rektorat, diskutoi rreth materialit përmbledhës, për të konkluduar në një dokument final, konkretisht: “*Deklarata e misionit të UART për vitet akademike 2024-2026*”, dokument i cili do t’u paraqitet organeve drejtuese, BA dhe SA, për ta miratuar.


Grupi i punës për menaxhimin Strategjik për Universitetin e Arteve, në veprimtarinë e tij, u mbështet në Ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e UART, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.


Në përfundim të diskutimeve të anëtarëve të grupit të punës, pa asnjë kundërshtim u konkludua në hartimin e dokumentit: “*Deklarata e misionit të UART për vitet akademike 2024-2026*”.


Bashkëlidhur: “*Deklarata e misionit të UART për vitet akademike 2024-2026*”.


Grupi i punës:


1. Prof. Kastriot Çaushi
2. Prof. Dr. Erald Bakalli
3. Prof. Dr. Isak Shehu
4. Prof. Petrit Malaj
5. Prof. Artan Peqini
6. Alma Sinanaj
7. Elia Plaku (Ademi)
8. Entela Ruka




















Adriatik Kraja,

Sekretar i GMS





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI

**DEKLARATA E MISIONIT E UNIVERSITETIT TË ARTEVE PËR VITET
AKADEMIKE 2024-2026**

MISIONI

Universiteti i Arteve edukon artistë të fushës së Muzikës, Artit Skenik dhe Arteve të Bukura bazuar në talent, eksperiencat dhe kualifikimet e trupës akademike me synim arritjen e standarteve më të larta nëpërmjet edukimit individual artistik dhe rritjes së kreativitetit.


Universiteti i Arteve si një institucion publik i arsimit të lartë ka për mision:

- a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, në fushën e artit dhe kulturës
- b) të nxisë e të zhvillojë kërkimin artistik/shkencor;
- c) të formojë specialistë të lartë të fushave të arteve
- d) të përgatisë artistë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit;
- e) të ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- f) të kontribuojë në zhvillimin artistik, ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal;
- g) të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit;
- h) të integrojë mësimdhënien me kërkimin artistik/shkencor;
- i) të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë dhe më gjerë;
- j) të nxisë formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të artit e kulturës;
- k) të nxisë thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit e kulturës;
- l) të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit;
- m) të krijojë gjithë përfshirjen e studentëve vendas dhe të huaj shqipfolës;
- n) të garantojë shprehjen e lirë në programet e tij mësimore të ideve kulturore, artistike dhe shkencore, që janë me karakter artistik, shkencor.

POLITIKA E PROGRAMIT

1. Përshkrimi i programit

Universiteti i Arteve është institucioni i vetëm publik i Arsimit të Lartë me karakter artistik në Shqipëri, që ofron Diplomë Universitare “Bachelor”, dhe “Master Shkencor/Master i Arteve”, “Master Profesional” në Muzikë, në Arte të Bukura dhe në Artet Skenike dhe gëzon status të veçantë në zbatim të VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu Universiteti i Arteve ofron edhe 2 programe të ciklit të tretë në Fakultetin e Artit dhe Fakultetin e Muzikës. Jemi në pritje të hapjes të programit të ciklit të tretë në Fakultetin e Arteve të Bukura.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

1.1. Përshkrimi i politikës së programit

Universiteti i Arteve përbëhet nga tre Fakultete dhe është institucioni unik në vend që ofron programe të fushave të arteve .

Nëpërmjet politikave të saj vlerëson prurjet më të mira artistike në vend dhe në të gjithë trevat shqipfolëse.

Universiteti i Arteve aktualisht përbëhet nga 3 njësi kryesore dhe 9 njësi bazë si më poshtë:

- Fakulteti i Muzikës
Departamenti Interpretimit
Departamenti Kanto
Departamenti Kompozicion-Muzikologji-Dirigjim-Pedagogji Muzikore
- Fakulteti i Artit Skenik
Departamenti Aktrimit dhe Teori
Departamenti Regji dhe Regji Filmi & TV
Departamenti Skenografi & Koreografi
- Fakulteti i Arteve të Bukura
Departamenti Pikturës
Departamenti Skulpturës
Departamenti Arteve të Aplikuara

Politika që mbështet UART, është në funksion të rritjes së standarteve të mësimdhënies me të gjithë komponentët përbërës, duke patur si qëllim parësor studentin dhe njësimin e programeve të studimit me Universitet në Europë.

UART mbështetet në resurset e saj akademike si dhe mbështetëse të saj.

Politika e programit mbështetet në treguesit potencial të UART, duke sjellë si rrjedhojë integrimin në mësimdhënie të stafit akademik në institucionet homologe në Evropë.

1.2. Qëllimi i politikës së programit

Qëllimi kryesor i saj është të ofrojë arsimim të lartë në tre cikle shkollimi në fushat e arteve, veprimtari krijuese dhe artistike/shkencore.

Të realizojë rritjen e standarteve të mësimdhënies me qëllim krijimin e specialistit të lartë në fushën e arteve dhe kulturës.

Kurrikula mësimore universitare të jetë objekt rishikimi dhe përafrimi me Universitetet Evropiane të fushës së artit.





1.3. Objektivat kryesore për vitet 2024-2026

Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe përvetësimit të dijeve në të gjitha programet e ofiuara nga UART, nëpërmjet:

- Rishikim periodik i kurrikulave mësimore për përmirësimin e tyre dhe rritjen e standarteve me ato homologe jashtë vendit;
- Përmirësimin në vazhdimësi të metodës së mësimdhënie;
- Sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, nëpërmjet zgjerimit të sistemit universitar, me Universitete të tjera në rajon dhe në Evropë duke krijuar lidhje bashkëpunimi reciproke në lëvizjen e stafëve akademike dhe të studentëve për përfitimin e diplomave dyfishe;
- Ambiente bashkëkohore, të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor, duke krijuar mundësi praktikiteti dhe funksionaliteti me laboratorë dhe mjete të tjera mbështetëse në funksion të procesit mësimor;
- Krijimin e laboratorëve të rinj dhe plotësimin e laboratorëve ekzistues me pajisje në ndihmë të procesit mësimor brenda kapaciteteve mbartëse si UART.
- Paurimi i programeve të studimit me lëndë rrisin mundësitë e qasjes ndaj tregut të punës, sidomos në përputhje me zhvillimet e teknologjisë.
- Hapja e ciklit të tretë të studimeve në FAB.
- Ndërkombëtarizim të prograneve të studimit, marrëveshje me institucionet e arsimit të lartë në botë.
- Plotësim dhe përmbushje e programit të studimit “Konservim Restaurim” për vitin e tretë bachelor dhe vitin e dytë master.
- Parashikim i hapjes së Ciklit të Dytë të Studimeve i programit të studimit “Konservim Restaurim” si një program i veçantë u cili do të hapet për herë të parë në kë të universitetet për Shqipërinë.
- Hapja e Ciklit të Dytë të studimeve në programin e studimit “Fotografi”.
- Krijimi i Qendrës Kërkimore Shkencore së Artit në UART, e cila do të realizojë misionin e saj duke kryer detyrat e mëposhtme:

-Zbaton legjislacionin kombëtar në fushën e artit, kulturës, shkencës dhe teknologjisë si dhe politikat e Rektoratit të UART-it në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në arte dhe kulturë;

-Aplikon në emër të UART-t në kuadër të projekteve shkencore kombëtare dhe atyre ndërkombëtare në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Bashkëpunon me stafin akademik, fakultetet dhe departamentet e UART-tit si dhe me institucionet e tjera shkencore për nxitjen dhe promovimin e kërkimit shkencor në fushat e arteve dhe të kulturës, të edukimit artistik, të trashëgimisë sonë kulturore (materiale dhe shpirtërore),
- Përgatit dhe publikon revistën artistike-shkencore "ARTI", si botim i Universitetit të Arteve-, Tiranë e cila përmban kontributet shkencore në fushën e studimit të arteve të stafit akademik, të studentëve dhe shkencëtarëve të rinj të UART-tit dhe më gjerë;
- Monitoron dhe përgatit raportet e vlerësimit për gjendjen dhe nivelin e kërkimit shkencor në Fakultetet e Universitetit të Arteve dhe në të gjitha programet e studimit në UART;
- Mbështet dhe bashkëpunon me personelin akademik të UART dhe më gjerë (si dhe me grupet kërkimore të ngritura pranë departamenteve, të UART-it, të cilat kryejnë dhe zbatojnë projekte kërkimore-shkencore në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore) duke sjellë ripërmasimin e vendit dhe të ngarkesës shkencore brenda ngarkesës mësimore të çdo anëtari të stafit akademik ;
- Nxit pjesëmarrjen e studentëve dhe të shkencëtarëve të rinj në veprimtarinë kërkimore shkencore në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë;
- Krijon, zhvillon dhe pasuron në bashkëpunim me Bibliotekën e UART-t, bazën e të dhënave, të analizës dhe të dokumentacionit kërkimor shkencor në fushën studimeve artistike dhe kulturore mbarëkombëtare etj.;

1.4. Produktet kryesore që do të ofrohen në vitet 2024-2026

- 35 programe studimi për të tre Fakultetet e UART për ciklin e parë të studimeve Bachelor dhe duke parë mundësinë e zgjerimit të tyre në vazhdimësi me programe të tjera të reja (jemi në proces të hapjes të një programi të ri në Fakultetin e Arteve të Bukura).
- 27 programe studimi për të tre Fakultetet e UART për ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Arteve dhe mësuesi.
- 4 programe studimi për Fakultetin e Muzikës në UART për ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master Profesional dhe mësuesi.
- 1 program studimi për Fakultetin e Muzikës në UART për ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Shkencave dhe mësuesi.
- Trajnim për formimin e vazhduar në modulin "Mësimdhënia e Muzikës për Nxënësit me Aftësi Ndryshe"
- Infrastrukturë mbështetëse e mësimdhënies e përmirësuar duke plotësuar laboratorët, sallat, klasat, atelierët dhe studiot me pajisje, mjete, lëndë të para, materiale dhe elemente të tjerë të mësimdhënies
- Punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar sipas kërkesave të kohës dhe në përshtatje me kurikulat mësimore.



1.4. Standardet e politikës të programit;

- Pajisjen me infrastrukturën e nevojshme të laboratorëve sipas specifikave të programeve të studimit të UART.
- Rritjen e vazhdueshme të kualifikimit të stafit akademik nëpërmjet workshopeve dhe kualifikimeve të tyre artistike dhe shkencore. Kualifikim të stafit administrativ në vazhdimësi duke ju përgjigjur ndryshimeve të kurikulës mësimore dhe risive të kohës.

Kurrikula mësimore e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë për programet e studimit të ofruara nga UART është krijuar në mënyrë të tillë që studenti pas përfundimit të jetë:

- Një artist me integritet.
- Të jetë aktiv në të mësuarit gjatë jetës si në fushën e artit dhe në disiplina të tjera akademike.
- Një qytetar i përgjegjshëm.

Një student i diplomuar në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master të demonstrojë:

- Arritje të rëndësishme në fushën profesionale të zgjedhur prej tij/saj ndër disiplina të ndryshme që studiohen në Universitetin e Arteve si në njohuritë teorike ashtu dhe aftësitë performuese.
- Aftësitë profesionale të nevojshme për të ndjekur një karrierë në fushën e artit.
- Të shprehë pikëpamje të pavarura.
- Të kryejë studime kritike.
- Të zgjerojë idetë dhe të eksplorojë çështje bashkëkohore.
- Të thellojë punën krijuese dhe artistike.
- Të ketë rol aktiv në komunitet.
- Të jetë një përçues i mirë në mësimdhënie sipas fushës së diplomimit.

2. Qëllimet kryesore për ciklin e tretë të shkollimit

- Jemi në proces të pritjes për vlerësimin e dokumentacionit nga MAS, për një program të ciklit të tretë të studimeve për Fakultetin e Arteve të Bukura dhe shpresojmë që brenda vitit akademik 2024-2026, këto program të jenë aktive në UART.





2.1. Objektivat kryesore për ciklin e tretë të shkollimit, viti 2024-2026

- Miratim dhe hapje e programeve të studimit të ciklit të tretë të studimeve, në Doktoraturë në FAB.
- Financim i projekteve kërkimore artistike/shkencore nëpërmjet konkurrimit.
- Zgjerim i aktiviteteve për përfshirjen e biznesit privat në programet kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit, në marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, si dhe financimi i projekteve artistike/shkencore.
- Kualifikime dhe trajnime të stafit akademik, ndihmës akademik dhe administratës.

2.2. Produktet kryesore që do të ofrohen në 2024-2026

- Programe të Doktoraturës për të tre fakultetet.

2.3. Standardet e politikës të programit që duhet të plotësohen për vitet 2024-2026

- Pajisja me infrastrukturën e nevojshme të laboratorëve sipas specifikave të programeve të studimit të UART.
- Rritjen e vazhdueshme të kualifikimit të stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.
- Akreditimi të programeve të studimit të ofruara nga UART për ciklin e parë të studimit Bachelor.

Në UART studentët nuk diskriminohen nga raca, ngjyra, besimi, seksi, mosha, nacionaliteti apo origjina etnike, orientimi seksual, aftësitë fizike apo aftësi mendore apo statuset e veçanta që mund të kenë, bazuar kjo në politikën e arsimit, të pranimit, punësimit, bursave që ndjek UART dhe në ligjin e Arsimit të Lartë si dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.



